



# KUSH I VUAJTI MASAT E BE-së NDAJ KOSOVËS? PAK DIHET | FAQE 4-5



Heqja e masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës mund të vështrësohet pas operacioneve të fundit policore në veri të vendit që

kanë rezultuar me mbyllje të disa objekteve të Bankës Kursimore të Postës së Serbisë. Kështu vlerësojnë disa diplomatë në Bruksel, teksa

presin raportin e kryediplomatit të bllokut evropian, Josep Borrell, për të kuptuar çfarë hapash ka bërë Kosova për heqjen e masave

**AKUZAT NDAJ  
SISTEMIT TË  
DREJTËSISË,  
PROKURORIA  
SPECIALE KËRKON  
NGA KURTI T'I  
SHMANGË  
DEKLARIMET  
PUBLIKE | F.3**



**KURTI EDHE NË  
NJË FUSHATË  
ZGJEDHORE,  
KËTË HERË PËR  
ZGJEDHJET  
NË LUGINË | F.7**



## AKTUALE



**NATO-ja E GATSHME PËR  
"MBËSHTETJE AFATGJATË" PËR  
UKRAINËN, THOTË STOLTENBERGU | F.2**

**LV-JA KËRKON HAPJEN  
E URËS MBI LUMIN IBËR | F.5**

**PRESIDENTI TURK PRET  
KURTIN NË TAKIM | F.3**

## EKONOMI



**ANKANDI I PARË SOLAR PREJ  
100 MW, INVESTIM NË VLERË  
MBI 70 MILIONË EURO | F.8**

**DOGANA E KOSOVËS PRANON  
1 360 APLIKIME PËR POZITAT  
E REJA DOGANORE, PROCESI DREJT  
PËRFUNDIMIT | F.8**

## SPORT



**SONTE DORTMUNDI DHE REALI  
KËRKOJNË TROFEUN E LIGËS SË  
KAMPIONËVE | F.10**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# NATO-ja e gatshme për “mbështetje afatgjatë” për Ukrainën, thotë Stoltenbergu

PRAGË, 31 MAJ - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha të premten se aleanca ushtarake duhet ta zgjerojë rolin e vet në mbështetjen e Ukrainës në luftën e saj kundër pushtimit të paprovokuar nga Rusia si dhe t'ia bëjë të qartë Moskës se mbështetja perëndimore për Kievin do të vazhdojë sa të jetë e nevojshme. “Ne duhet të sigurohemi që Moskë ta kuptojë se ne jemi të gatshëm për mbështetje afatgjatë për Ukrainën”, tha Stoltenbergu për gazetarë, në ditën e dytë të takimit të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Pragë.

Në takimin e NATO-s në kryeqytetin çek, në të cilin po merr pjesë edhe sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, do të diskutohet për një



paketë të ndihmës për Ukrainën, e cila do të paraqitet në samitin e NATO-s në Uashington në korrik. Gjatë takimit të ministrave pritet të bisedohet për një plan të paraqitur nga Stoltenbergu në prill, që ka të bëjë me një kornizë, e cila do ta bartte përgjegjësinë për ndihmë ushtarake dhe civile

për Ukrainën nga një grup joformal i udhëhequr nga ShBA-ja, te strukturat formale të aleancës.

NATO-ja nuk e furnizon zyrtarisht Kievin me armë vdekjeprurëse ushtarake, por vende individuale të NATO-s ka kohë që e furnizojnë atë përmes Grupit të Kontaktit

për Ukrainën (UCG), një nismë e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara, e cila joformalisht njihet si Grupi Ramshtajn. “Ne do të bisedojmë si ta ruajmë dhe përshpejtojmë mbështetjen për Ukrainën. Unë kam propozuar që NATO-ja të luajë rol më të madh në bashkërendimin e furnizimit me ndihmë të sigurisë dhe stërvitje për Ukrainën. Kam propozuar edhe një zotim financiar shumëvjeçar për të garantuar më shumë dhe logaridhënie të parashikueshmëri në mbështetjen që ia ofrojmë Ukrainës”, tha Stoltenbergu. Ministrat me gjasë do të bisedojnë për lejimin e Kievit që t'i përdorë armët me të cilat e furnizon Perëndimi për të kryer sulme brenda Ruisë. Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania u

pajtuat që Ukraina t'i përdorë armët e tyre për një gjë të tillë, por me kushte të caktuara. Kievi ka “të drejtë me ligj ndërkombëtar ta mbrojë veten” kundër sulmeve që bëhen prej Ruisë, afër kufirit me Ukrainën, tha Steffen Hebestreit, zëdhënësi i kancelarit gjerman Olaf Scholz. Ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, Boris Pistorius, ndërkohë sqaroi se Ukrainës i lejohet t'i përdorë armët “vetëm për t'i luftuar sulmet ruse” në rajonin e Harkivit, i cili është duke u sulmuar paseshtur nga Rusia javët e fundit. Stoltenbergu përsëriti të premten se aleatët duhet ta shqyrtojnë heqjen e kufizimeve për përdorimin e armëve të NATO-s nga Ukraina për t'i goditur caqet në territorin rus, sepse është pjesë e së drejtës së Kievit për vetëmbrojtje.

## OKB-ja thotë se 114 milionë persona u zhvendosën për shkak të konflikteve

NJU-JORK, 31 MAJ - Numri i personave që janë larguar nga shtëpitë e tyre për shkak të luftërave, dhunës dhe përndjekjes, ka arritur në 114 milionë dhe ky numër po rritet për shkak se shtetet kanë dështuar që t'i luftojnë shkaqet, teksa palët e përfshira në luftë po vazhdojnë të refuzojnë ta respektojnë ligjin ndërkombëtar. Kështu tha shefi i agjencisë së Kombeve të Bashkuara për refugjatë, Filipino Grandi. Ai kritikoi Këshillin e Sigurimit të OKB-së, që është përgjegjës për mirëmbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, duke thënë se ka dështuar ta përdorë zërin e tij për të tentuar që t'i zgjidhë konfliktet duke nisur nga Gaza e Ukraina

dhe nga Sudani e deri në Kongo, Mianmar dhe pjesë të tjera. Ai, po ashtu, akuzoi shtete - pa përmendur emra - se po marrin “vendime shkurtpamëse të politikës së jashtme që shpesh janë të bazuara në standarde të dyfishta, që vetëm deklarojnë se respektojnë ligjin, por që Këshilli ka pak fuqi që të respektohen paqja dhe siguria”. Grandi tha se mosrespektimi i ligjit ndërkombëtar do të thotë se “palët në konflikt” kanë “ndaluar së respektuari ligjet e luftës” edhe pse disa prej tyre pretendojnë se po i respektojnë. Rezultat i gjithë kësaj janë më shumë vdekje të civilëve, përdorimi i dhunës seksuale si armë në luftë, sulmet dhe



shkatërrimet e spitaleve, shkollave dhe infrastrukturës tjetër civile dhe shënjestrimi i punëtorëve humanitarë, tha Grandi. Grandi kritikoi Këshillin e

Sigurimit për shkak të dhjetëra mijëra personave të vrarë në Gazë, Ukrainë, Sudan dhe në konflikte të tjera. “Por, nuk është vonë që të vendosni fokusin dhe energjinë

tuaj në krizat dhe konfliktet që janë ende të pazgjidhura, në mënyrë që ato të mos përkeqësohen dhe të shpërthejnë sërish. Nuk është vonë që të ndihmoni miliona persona që janë zhvendosur me forcë”, tha ai. Këshilli i Sigurimit është shumë i polarizuar, teksa pesë shtetet që kanë fuqinë e vetos shpesh bllokojnë vendime. Sa i përket luftës në Gazë, Këshilli nuk ka bërë thirrje për armëpushim, për shkak të kundërshtimit nga Shtetet e Bashkuara. Ndërkaq, sa i përket Ukrainës, Këshilli ka qenë joefektiv pasi që Rusia mund të përdorë veton për të bllokuar miratimin e çdo rezolute të mundshme.

## ShBA-ja thotë se Rusia po përdor raketa të Koresë së Veriut në Ukrainë



WASHINGTON, 31 MAJ - Rusia po përdor raketa balistike të Koresë së Veriut në Ukrainë, u tha në një raport të ri të Pentagonit. Raporti bazohet në analizat e fragmenteve të raketave dhe sipas Shteteve të Bashkuara konfirmon pretendimet e kamotshme se Pheniani po i dërgon armë Moskës. Raporti i Agjencisë për Inteligjencë të Mbrojtjes të Pentagonit ka analizuar imazhe për të konfirmuar se fragmentet e raketave që u gjetën në janar të këtij viti në rajonin ukrainas të Harkivit ishin të një raketave balistike me rreze të shkurtër veprimi të prodhuar në Kore të

Veriut. “Analiza konfirmon se Rusia ka përdorur raketa balistike të prodhuara në Kore të Veriut në luftën e saj kundër Ukrainës”, tha kjo agjenci përmes një deklaratë. Koreja e Jugut e ka akuzuar Phenianin se ka dërguar mijëra kontejnerë me municione në Rusi. Dërgesa të tilla do të përbënin shkelje nga të dyja shtetet të sanksioneve të vendosura nga Kombet e Bashkuara. Pheniani dhe Moskë kanë forcur lidhjet e tyre muajve të fundit. Lideri verikorean, Kim Jong Un, ka vizituar Rusinë vitin e kaluar dhe është takuar me presidentin rus, Vladimir Putin.

Kremlini tha për mediat ruse gjatë këtij muaji se “po përgatitet” një vizitë e Putinit në Korenë e Veriut. Herën e fundit që Putin ka vizituar Phenianin ka qenë në vitin 2000, vetëm disa muaj pasi është zgjedhur president i Ruisë. Atëbotë, ai ishte takuar me Kim Jong Il, babanë e Kim Jong Un. Në bazë të sanksioneve të OKB-së, Koresë së Veriut nuk i lejohet të kryejë teste të teknologjisë balistike. Por, në mars Moskë vendosi veto në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke i dhënë fund monitorimit të shkeljeve të sanksioneve të kësaj organizate.



## Haxhiu ironizon me partitë opozitare për zgjedhjet e parakohshme

PRISHTINË, 31 MAJ - Ministria e Drejtësisë nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, përmes një video ka ironizuar me partitë opozitare lidhur me kërkesën e tyre për zgjedhje parlamentare. Sipas ministres, opozita ka kërkuar

zgjedhje të parakohshme parlamentare që tri vjet e në fund ka dështuar. "Për më shumë se tri vjet opozita thoshte zgjedhje, zgjedhje, zgjedhje. Pastaj, ditë më parë doli kryeministri dhe u tha jemi të gatshëm për zgjedhje. Pastaj po e dini të gjithë çka

ndodhi...", ka shkruar Haxhiu në profilin e vet zyrtar në "Facebook". Subjektet opozitare, përkundër thirrjeve që kanë bërë për rrëzimin e qeverisë, nuk kanë mundur të gjejnë pajtueshmëri për mënyrën se si të shkohet në zgjedhje.



## Akuzat ndaj sistemit të drejtësisë, Prokuroria Speciale kërkon nga Kurti t'i shmangë deklaratimet publike

PRISHTINË, 31 MAJ - Prokuroria Speciale e Kosovës ka bërë një reagim ndaj deklaratave të djeshme të kryeministrit Albin Kurti lidhur me rastet e krimeve të luftës. Kurti të enjten tha se janë bërë pesë vjet prej kur institucioneve tona të drejtësisë u është mundësuar ndjekja penale dhe gjykimi i kriminelëve të luftës edhe në mungesë të tyre e, sipas tij, ende nuk ka asnjë rezultat.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës shpreh indignatë të thellë ndaj qasjes së vazhdueshme joproduktive të kryeministrit Kurti ndaj Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës lidhur me rastet e krimeve të luftës. "Prokuroria Speciale potencon fuqishëm se komentet e vazhdueshme të kryeministrit të Kosovës për punën e Prokurorisë Speciale janë në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe standardeve ndërkombëtare për

pavarësinë e gjyqësorit. Andaj, si të tilla, e minojnë besimin e publikut në punën e prokurorit të shtetit në përgjithësi dhe të Prokurorisë Speciale në veçanti", thuhet në reagim.

Më Tutje, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës e njofton opinionin publik se në pesë vitet e fundit, që nga koha kur kjo prokurori ka marrë kompetencat për hetimin e krimeve të luftës, ka bërë punë jashtëzakonisht të madhe në bashkëpunim të plotë me institucionet ligjzbatuese. "Për më tepër, kjo është bërë me kapacitete të pamjaftueshme të kadrove profesionale dhe financiare si pasojë e buxhetit të pamjaftueshëm. KPK sjell në vëmendje të opinionit publik se në 20 vitet e fundit asnjëherë nuk është miratuar kërkesa e plotë buxhetore (në lartësinë 100 % të kërkesës). Gjithashtu, korniza ligjore për hetimin e krimeve të luftës ka ndryshuar shumë në pesë vitet e fundit", theksohet tutje.



Më tej, Prokuroria Speciale shton se "ky ndryshim ka paraqitur sfidë për një proces efikas dhe efektiv në hetimin e krimeve të luftës". "Këtë sfidë nuk e kanë shtetet e tjera në region. Shtetet si Kroacia dhe Bosnjë-Hercegovina kanë miratuar strategjitë nacionale në nivel të qeverive dhe parlamenteve të vendeve të tyre për adresimin e krimeve të luftës. Ne ende nuk e kemi një strategji të tillë në nivel nacional". "Përkundër kësaj, me

iniciativën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar Strategjinë e Krimeve të Luftës, mbi bazën e së cilës janë duke u zhvilluar hetimet e krimeve të luftës", vijon reagimi. Prokuroria Speciale thekson se "Edhe me këto resurse të pamjaftueshme, si ligjore ashtu edhe financiare, njoftojmë opinionin publik se Prokuroria Speciale aktualisht ka të

regjistruara gjithsej 60 aktakuza për krime të luftës për 56 raste ndaj 165 personave". "Po ashtu, ju informojmë se ka përfunduar proceduara e avancimit të prokurorëve nga ana e Këshillit Prokurorial dhe duke filluar nga data 1 qershor 2024, në Departamentin për Hetimin e Krimeve të Luftës në Prokurorinë Speciale do të shtohen edhe dy (2) prokurorë. Numri total i prokurorëve në këtë departament do të jetë pesë (5), të cilët do të merren ekskluzivisht me hetimin e krimeve të luftës", thuhet në reagim.

Prokuroria Speciale i bën thirrje publike kryeministrit dhe çdo zyrtari tjetër shtetëror që t'i shmangë deklaratimet publike të cilat nuk përkohet me gjendjen reale dhe i fton qytetarët për bashkëpunim me organet e rendit, në mënyrë që të gjithë ata individë që kanë kryer vepra penale të krimeve të luftës të dalin para drejtësisë.

## "Mashtrimi i pensionistëve", Murati: Ata që dezinformuan do të përballen me ligjin

PRISHTINË, 31 MAJ - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka deklaruar se të gjithë personat që i kanë dezinformuar pensionistët se mund të përfitojnë në mënyra të ndryshme pa njoftim zyrtar të qeverisë, do t'u nënshtrohen organeve të rendit.

Ai ka kërkuar nga qytetarët të mos bien pre e këtyre keqinformimeve. Gjithashtu, ka njoftuar se tashmë policia ka nisur hetimet. "Tashmë kemi edhe një hetim nga policia, pra është një dezinformate, një keqinformim që po ndodh nga disa qarqe, nga disa persona të



papërgjegjshëm, por ne edhe kemi lëshuar komunikatë lidhur me këtë, dhe për çdo detaj, personat që keqinformohen në mënyrë të tillë, duhet t'i drejtohen organit të rendit, njëkohësisht për çdo ndryshim që thuhet se bëhet duhet të shohin se a ka qëndrim zyrtar dhe deklarim zyrtar nga Ministria e Financave, sepse sigurohemi që çdoherë t'i informojmë me kohë për çfarëdo mase", thotë Murati për kp.

Ata që i kanë besuar kësaj dezinformate janë shumë, të cilët kanë aplikuar duke besuar se do të përfitojnë nga kjo masë.

Madje ata kanë dhënë edhe para për t'i rregulluar dokumentet që janë kërkuar nga pensionistët.

Qytetari Qazim Berisha, i cili ka rënë pre e kësaj, ka thënë se ka aplikuar dhe ka qenë në pritje të marrë para. "Kemi aplikuar. Na kanë kërkuar dokumentet. I kemi dërguar çfarë kanë kërkuar. I kemi marrë dokumentet në bankë. Letërnjoftimin fotokopje. I kemi dorëzuar të gjitha, por çfarë bëjnë tash nuk e di", thotë Berisha.

Kurse një qytetar tjetër, i cili ka dashur të mbesë anonim, ka thënë se ka dhënë edhe para për t'i rregulluar dokumentet.

## Presidenti turk pret Kurtin në takim

PRISHTINË, 31 MAJ - Presidenti i Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka pritur të premtën në takim kryeministritin e vendit, Albin Kurti.

Kurti është i shoqëruar në këtë vizitë nga zëvendëskryeministri

Besnik Bislimi dhe zëvendëskryeministria Emilija Rexhepi.

Presidenca turke ka publikuar pamje të pritjes së kryeministrit të Kosovës, Kurtit.

Gjatë javës në Stamboll do të mbahet Forumi i Parë

Ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe Turqisë ku do të marrin pjesë biznese të shumta nga Kosova dhe Turqia si një mundësi unike për t'i zgjeruar mundësitë e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar.







# Kush i vuajti masat e BE-së ndaj Kosovës? Pak dihet

Heqja e masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës mund të vështirësohet pas operacioneve të fundit policore në veri të vendit, që kanë rezultuar me mbyllje të disa objekteve të Bankës Kursimore të Postës së Serbisë. Kështu vlerësojnë disa diplomatë në Bruksel, teksa presin raportin e kryediplomatit të bllokut evropian, Josep Borrell, për të kuptuar çfarë hapash ka bërë Kosova për heqjen e masave

**PRISHTINE, 31 MAJ** - Është bërë gati një vit prej kur Bashkimi Evropian ka vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës, por pak dihet se kush është dëmtuar më së shumti nga ky vendim. Cilat programe, çfarë ka ndodhur me ata individë a programe që janë prekur, dhe sa ka qenë shumta e fondeve? Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, pati thënë në janar të këtij viti se në rrafshin politik, masat janë të kufizuara vetëm në takimet e nivelit të lartë me përfaqësues të institucioneve të Kosovës. “Është ndaluar vlerësimi dhe miratimi i aplikimeve të reja të Kosovës në kornizën e Ballkanit Perëndimor për investime, që do të thotë se Kosovës nuk i

është ndaluar asnjë projekt, por aplikime të reja nuk janë aprovuar ende, dhe janë ndaluar prokurimet e reja të projekteve që burojnë nga IPA 2023 [Instrumentet e Para-Anëtarësimit], dhe nuk kanë filluar diskutimet për IPA 2024. Nuk janë prekur prokurimet ekzistuese”, pati thënë Bislimi. Por, Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane, thotë për Radion Evropa e Lirë se disa projekte janë pezulluar: “Nuk janë anuluar, janë pezulluar, dhe së paku në një rast, Kosovës i është mohuar e drejta e aplikimit për fonde të reja në kuadër të raundit të kaluar të kornizës investuese për Ballkanin Perëndimor”.

Ai e përmend edhe pezullimin e takimeve të grupeve punuese për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA), paktit të parë kontraktual ndërmjet Kosovës dhe bllokut evropian. Radio Evropa e Lirë e ka pyetur Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës, për më shumë hollësi, por nuk ka marrë përgjigje. Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se autoritetet në Kosovë janë “të informuara mirë” se cilat masa rëndojnë mbi Kosovën duke përmendur fondet e IPA-s 2024, kornizën e investimeve për Ballkanin Perëndimor dhe takimet për MSA, por pa ofruar më shumë hollësi.

Vendimi për masa është marrë mbi arsyetimin se Kosova nuk ka bërë mjaftueshëm për t’i ulur tensionet në veri të vendit, në maj dhe qershor të vitit të kaluar.

Hollësitë mbi masat nuk janë bërë të ditura as kur janë komunikuar ato. Në fakt, diçka e tillë nuk është e zakonshme për BE-në.

Shembull, kur BE-ja ka marrë vendim për ta sanksionuar Rusinë për luftën e nisur në Ukrainë, më 2022, Komisioni Evropian ka votuar për to, si dhe ka votuar e do të votojë çdo vit për shtyrjen e tyre.

Në vendim përmendet me emër secili individ dhe entitet i prekur rus.

Në rastin e Kosovës, për masat nuk është votuar - me arsyetimin se janë të përkohshme - vetëm është thënë se Komisioni Evropian është përgjegjës për to dhe, rrjedhimisht, janë pa ndonjë afat.

## Si mund të hiqen masat?

Disa javë pas vendosjes së masave, BE-ja pati arritur

marrëveshje me Kosovën për shtensionimin e situatës në veri në këmbim të heqjes së masave. Ndër kërkesat kryesore kanë qenë zvogëlimi i pranisë policore në dhe përreth ndërtesave komunale në veri të Kosovës dhe organizimi i zgjedhjeve të reja. Autoritetet e Kosovës kanë thënë se i kanë përmbushur të dyja.

Aktualisht kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, është duke e përpiluar një raport rreth hapave që ka marrë Kosova për t’iu hequr masat. Por, së fundmi është bërë me dije se aty do të përfshihen edhe operacionet policore të majit të këtij viti në pjesën veriore, që kanë rezultuar me mbyllje të disa objekteve të Bankës Kursimore të Postës së Serbisë.

Si BE-ja, ashtu edhe Shtetet e Bashkuara, e kanë kritikuar Kosovën për këto aksione, duke i konsideruar “të pakoordinuara dhe të njëanshme”.

Për pasojë, ka zëra në BE që besojnë se tani do të vështirësohet procesi i heqjes së masave ndaj Kosovës. Por, njëkohësisht, disa burime i



# Kurti edhe në një fushatë zgjedhore, këtë herë për zgjedhjet në Luginë

PRISHTINË, 31 MAJ - Në fillim të majit anëtarë të partisë së kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, morën pjesë në zgjedhjet parlamentare në Maqedoninë e Veriut. Në fillim të qershorit, dy këshilltarë të qeverisë së tij do të garojnë në zgjedhjet lokale në dy komuna me shumicë shqiptare në jug të Serbisë. Si atëherë, edhe tash, ky angazhim ngjalli reagime. U cilësua edhe si "tendencë për ta shtrirë ndikimin te shqiptarët në rajon", edhe si përpjekje për "përçarje".

Vetë Zyra e Kurtit nuk iu përgjigj interesimit të REL-it për ta komentuar mbështetjen e shprehur të kryeministrit për kandidatë të caktuar.

Një ditë më herët Kurti mori pjesë në një tubim të Partisë për Veprim Demokratik që u mbajt në Prishtinë.

Ardita Sinani nga kjo parti është këshilltarë politike e Kurtit dhe do të garojë për kryetare të komunës së Preshevës në zgjedhjet e 2 qershorit.

Ragmi Mustafi, po nga kjo parti, është këshilltar i zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe do të garojë për kryetar të Bujanocit. "Më kanë thënë që nuk bën të marr pjesë vetëm te dy kandidatë... Unë shkoj aty ku më thërrasin", tha Kurti në

tubimin ku ishin të pranishëm edhe Sinani, edhe Mustafi.

Ai u bëri thirrje votuesve në Preshevë e Bujanoc t'i mbështesin këta dy kandidatë.

Partia për Veprim Demokratik - që vepron në Luginë të Preshevës, apo komunat Preshevë, Bujanoc e Medvegjë - është e përfaqësuar në Kuvendin e Serbisë me deputetin Shaip Kamberi.

Nga kjo parti thonë se për shqiptarët e Luginës ekzistojnë dy rrugë: "ose t'i ndjekin politikën e Beogradit, ose të Prishtinës".

PVD-ja, sipas tyre, i ka zgjedhur ato të Prishtinës.

"Ne e konsiderojmë si kryeqendër të shqiptarëve Prishtinën. Ne e konsiderojmë për kryeministër kryeministrin e Republikës së Kosovës. Për ne kjo është më se e qartë. Për të tjerët... shpresoj që edhe ata ta kuptojnë", tha Mustafi për Radion Evropa e Lirë.

Sinani nuk pranoi të fliste për REL-in, por gjatë fjalimit që mbajti në tubim, Kurtit iu drejtua si "kryeministër i shqiptarëve të Luginës së Preshevës".

Partitë shqiptare në Preshevë do të garojnë me gjashtë lista zgjedhore, ndërsa në Bujanoc me katër.

Disa përfaqësues të tyre, me të



cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë, thanë se bashkëpunimi me Kosovën është jetik për ta pavarësisht se kush është në krye të qeverisë së saj.

Por, mbështetja e Kurtit vetëm për Partinë për Veprim Demokratik, sipas kreut të Alternativës për Ndryshim, njëherësh kandidat për kryetar të Preshevës, Visar Mehmeti, ka trazuar skenën politike dhe votuesit potencialë. "Përçarje, pa diskutim, do të mbjellë. Vetëm ka filluar dhe besoj që,

ditëve të ardhshme, do të shtohet doza e përçarjes mes subjekteve [politike] dhe mes votuesve", tha Mehmeti për Radion Evropa e Lirë.

Kandidati për kryetar të Preshevës, Sami Salihu, nga Lëvizja për Reforma, tha se mbështetja e Kurtit për vetëm një subjekt politik, "nuk i shërben forcimit të demokracisë lokale në Luginën e Preshevës". "Për pushtet lokal, gara është e brendshme. Ndërhyrja e

minon demokracinë", sipas Salihut.

Me tone kritike u shpreh edhe kryetari aktual i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi, drejtues i Partisë Demokratike dhe kandidat i saj edhe për një mandat. "Kryeministri i Republikës së Kosovës duhet t'i ftojë shqiptarët të dalin të votojnë dhe, normalisht, të votojnë sipas dëshirës dhe mendjes së tyre. Por, jo të bëjë thirrje se cilin subjekt ose cilin kandidat ta votojnë", tha Arifi.

## LV-ja kërkon hapjen e urës mbi lumin Ibër

MITROVICË, 31 MAJ - Gjatë seancës së Kuvendit të komunës së Mitrovicës së Veriut, asamblistët e Lëvizjes Vetëvendosje më 31 maj kërkuan që të zbatohet vendimi për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër për trafik, e cila që nga viti 1999 e ndan Mitrovicën në pjesën jugore, të banuar me shumicë shqiptare, dhe në pjesën veriore, të banuar me shumicë serbe.

Asamblistja e LV-së, Aida Ferati-Doli, tha se çështje e urës mbi Ibër ishte diskutuar në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian më 2015 dhe "është mbyllur kjo çështje". Sipas saj, çështja e urës u takon dy komunave, të Mitrovicës së Veriut dhe të Jugut si dhe



Republikës së Kosovës. "Vendimi që e kemi marrë vitin e kaluar nuk duhet të kthehet asnjëherë mbrapsht. Gjithsesi, qytetarët e kanë parë deklaratën dhe kanë filluar të pyesin kur do

të hapet dhe do të thotë janë shumë të entuziazmuar dhe të gëzuar për këtë çështje", tha ajo gjatë mbledhjes së Kuvendit Komunal më 31 maj.

Në seancë, kryetari i Kuvendit

të Komunës së Mitrovicës së Veriut, Nexhad Uglanin, tha se është për hapjen e urës, për lëvizjen e lirë "sipas standardeve evropiane". "Ne e përkrahim çdo lëvizje, ura s'na duhet si simbolikë, por na duhet për bashkëjetesë mes komuniteteve", tha ai.

Seanca e Kuvendit të komunës së Mitrovicës së Veriut ka vazhduar pa praninë e medieve. Nga Lista Serbe, partia kryesore politike e serbëve të Kosovës, thonë se ura nuk mund të hapet pa pëlqimin e komunitetit serb. Bashkimi Evropian, që ndërmjetëson dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, thotë se çështja e urës mbi lumin Ibër duhet të zgjidhet në

kuadër të dialogut në Bruksel. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, tha se ka pasur shumë diskutime dhe pak hapa për zgjidhjen e tyre, duke theksuar se blloku evropian është i interesuar që të mos ketë kriza të reja. "Hapja e urës është pjesë e dy marrëveshjeve. Por, përkundër përpjekjeve tona, kjo urë ka mbetur e mbyllur për trafik. Pasi kjo është pjesë e dialogut, gjithçka duhet të diskutohet dhe të vendoset në dialog me pjesëmarrjen e Kosovës dhe Serbisë", tha Stano në një deklaratë për medie më 31 maj. "Vazhdojmë t'i ftojme palët që t'i zbatojnë marrëveshjet e dialogut, e kjo vlen edhe për urën", shtoi zëdhënësi i BE-së.

kanë thënë REL-it se ka edhe vende anëtare të BE-së që janë të zemëruara, pasi besojnë se masat kanë shkruar përtej asaj që është pritur.

### Çfarë thonë zyrtarë të Kosovës?

Të gjithë kërkojnë heqjen e masave.

Ministri i Financave, Hekuran

Murati, ka thënë ditë më parë se për shkak të mungesës së fondeve të BE-së, si rezultat i masave, Kosova është detyruar të ndajë fonde shtesë për një projekt nga i cili përfitojnë minoritetet.

Demush Shasha beson se Kosova duhet të marrë hapa për ta bindur bllokun evropian për heqje të masave, sepse nuk ka tjetër alternativë: "Nuk besoj se duhet parë nga optika e

drejtësisë apo e padrejtësisë, por duhet parë nga optika e obligimeve që ka marrë Kosova në kuadër të procesit të integritimit evropian, dhe kjo nuk është aq shumë çështje e drejtësisë".

Klisman Kadiu, nga zyra e zëvendëskryeministrit Bislimi, thotë për Radion Evropa e Lirë se situata në veri është shtensionuar dhe masat nuk kanë më kuptim. Sipas tij,

çfarëdo konstatimi tjetër në raportin e Borrellit "do të ishte i padrejtë, do të përbente shtrembërim të zhvillimeve në terren dhe domosdoshmërisht keqpërdorim të njëanshëm dhe të pakuptimtë të masave nga ana e KE-së".

Edhe zyrtarë të tjerë qeveritarë në Kosovë insistojnë që masat janë të padrejta. Ata ngrenë shpesh paralele me vendosjen e masave të BE-së ndaj Kosovës

dhe mosvendosjes së masave ndaj Serbisë për sulmin vdekjeprurës në Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit të kaluar.

Kosova e fajëson Serbinë për sulmin, të cilin e quan terrorist. Beogradi i hedh poshtë këto akuza. Bashkimi Evropian ka thënë se është në pritje të një raporti nga autoritetet e drejtësisë së Kosovës për të marrë më pas një vendim.



# Ali Ajeti - vigjilenti lirishtës (3)

## Lajmi për humbjen e Aliut dhe varrimi i tij

(Në 35-vjetorin e rënies heroike)

**Basrie MURATI-SAKIRI**

Me t'u errësuar, dikush nga shokët më tha të shkoja te shtëpia e Hafie Zebicës, një shoqe e imja gjimnazi, shtëpia e së cilës ishte afër, që t'i dëgjoja lajmet. Kur arrita atje, prindërit e saj ishin shumë të shqetësuar nga lajmet që kishin dëgjuar gjatë ditës edhe nga fakti se ajo ende nuk ishte kthyer nga shkolla. Në lajme ishte bërë e ditur se pas demonstratës kishte pasur përleshje të armatosura. Ky lajm më tronditi dhe nga shqetësimi nuk më pritej derisa të dëgjoja lajmet me veshët e mi. Për demonstratën që u mbajt në Podujevë, lajmi qe shumë i shkurtër. Spikerja raportoi, se pas demonstratës që ishte zhvilluar në qytet, policia kishte rrethuar Shtedimin dhe fshatrat përreth, ku kishte pasur shkëmbim zjarri nga të dy palët. Në fushat e Shtedimit kishte rënë një demonstrues me emrin Arben Ajeti. Supozohet se kishte edhe shumë të plagosur. Lajmi për vrasjen e Arben Ajetit më shtangu. Menjëherë më ra ndërmend se Aliu e mbante me vete letërnjoftimin e vëllait të tij që e quanin Arben. Prapë nuk i besoja ose më mirë të them nuk doja të besoja. Mos e tha spikerja gabimisht? Qëndrova deri në fund të lajmeve. Ajo përsëriti se ai ishte vrarë në rezistencë e sipër me policët.

Ta humbim Aliun, shokun tonë më të mirë?! E pabesueshme! Përnjëherë më dilte përpara, se sa i gjallë, i mençur e trim ishte ai. Për shkak të tronditjes nuk di se si jam përshëndetur me prindërit e Hafies dhe si kam dalë nga dyert e oborrit. Derisa kam arritur te shokët, hapat më janë dukur shumë të rëndë e lavrat e arave nëpër të cilat ecja edhe më të thella se më parë. Kështu që ai udhëtim prej 300-400 metrash më është dukur i pafund. Kur kam arritur te shokët, ata menjëherë më pyetën të shqetësuar:

"Çka ka të re?" Unë s'mund të nxirrja zë nga goja.

Por ata vazhduan të pyesin: "Çka ka ndodhur? Pse u vonove?"

Nuke di se ku e gjeta forcën për t'ua përcjell lajmin e hidhur: "Në Shtedim kishte pasur përleshje në mes të policisë e demonstruesve. Kishte edhe të plagosur. Ndër demonstruesit ishte edhe një i vrarë që e quanin Arben!" Pastaj nuk kam mundur të nxjerrë zë.

"Ueh, na e paskan vra Aliun, bre!", tha njëri prej shokëve. Në atë moment asnjëri prej nesh nuk ka mundur të nxirrte fjalë nga goja.

E ndjenim veten shumë keq që nuk ishim afër shokëve tanë t'u vinim në ndihmë dhe mbështetje. Si t'ia bënim? Pasi nuk shihnim

rrugëdalje tjetër, ngase rreziku ishte tejet i madh, vendosëm të shkonim në një bazë në hyrje të qytetit. Ecnim me sytë katër duke përgjuar se mos na vërente njeri, ose mos binim në duartë e policisë. Një burrë bujar na pritë në shtëpinë e tij. Ai ishte mësuar me pranimin e ilegalëve. Sapo u ulëm, nisi të përloje dhe nëpër ata lot na ngushëlloi për humbjen e Aliut. Aliun e "Mësuesin" nuk i lëshonte nga goja, sepse ata të dytë kishin qenë përpara disa herë të strehuar tek ai. Ai shprehu shqetësimin se mos ishte plagosur edhe "Mësuesi" (siç i thoshte ai Sabri Kiçmarit). Varur në një varëse, më ranë në sy disa nga rrobat e Aliut dhe përnjëherë m'u duk se e pashë edhe atë. Por, jo! Ai ishte vrarë nga plumbat e armikut gjakpirës. Aliu kishte rënë në altarën e lirisë për të mos vdekur kurrë.

Atë natë nuk kemi fjetur deri vonë. Qetësinë e prishnin vetëm i zoti i shtëpisë, Ramush Fazlia dhe dhëndri i tij, të cilët na shoqëronin dhe mundoheshin të na largonin dhembjen që kishim për Aliun. Njëkohësisht, nuk e dinim se ku gjëndeshin e ç'kishte ndodhur me Sabri Kiçmarin, Safet Ajetin e shumë nxënës të tjerë, të cilët nuk ishin ilegalë por që kishin qenë me ne në demonstratë. Atë natë vendosëm të bënim roje, sepse ishte natë e rrezikshme. Nuk besoja të ketë mbyllur sy ndokush prej nesh. Ishim të mërziut për rënien e Aliut, por edhe të shqetësuar për fatin e shumë të tjerëve. Agimi gdhui shumë ngadalë atë natë.

E vështirë qe nata e 30 majit për ne, por edhe më e vështirë ishte e nesërmeja. Atë ditë e varrosnin shokun tonë Aliun, derisa ne ishim të detyruar të qëndronim brenda atyre mureve, që na dukeshin gjithnjë e më të ngushta. Baca Ramush me dhëndrin e tij shkuan në varrim, kurse ne mbetëm brenda. Nuk mbaj mend të kem pasur ditë më të vështirë deri atëherë. Asnjë prej neve nuk nxirrte zë nga goja. Mbretëronte heshtje varri. Shpirtërisht ne morëm pjesë në varrim edhe pse fizikisht ishte e pamundur.

Në mbrëmje, të dy burrat u kthyen dhe na treguan për varrimin e mahnitshëm, që iu kishte organizuar Aliut. Mijëra vetë kishin marrë pjesë. Të gjithë kishin qenë krenarë për dëshmorin, i cili kishte rënë heroikisht duke mbrojtur flamurin dhe shokët. Por, dhembja shpirtërore ishte e madhe, sepse kishin humbur një burrë trim e vigjilent. Shumë nga të pranishmit ishin betuar se do ta vazhdonin rrugën e tij deri në fitore. Dhe me të vërtetë ashtu ndodhi. Aliu ra, por mijëra të tjerë u ngritën. Mbi të gjitha u kishte lënë përshtypje trupi i mbështjellë me flamur dhe qëndresa e prindërve të Aliut,



sidomos e nënës. Gjatë varrimit ishin lexuar nekrologji. Edhe aty kishte ndërhyrë policia, sepse kishin dyshuar se edhe ne mund të merrnim pjesë në varrim. "Ah, gjakpirës!", shfryva me vete.

### Si kishte rënë Aliu, dëshmori ynë i ri?

Vdekja e Aliut qe e vështirë për ne, mirëpo fakti se nuk kishim asnjë lajm për Bajramin, Sabriun, Safetin e shokët tjerë, nuk ishte më e lehtë. Meraku për ta vetëm sa rritej, sepse askush nga ne nuk dinte se ku mund të ishin ata. Mos ishin të plagosur apo mos i kishte arrestuar policia? A kishin mundur të strehoheshin gjëkund? Ky ankth zgjati dy ditë, deri atëherë, kur Sabriu e Safeti erdhën tek ne. Së pari i shprehëm ngushëllime njëri-tjetrit për Aliun.

"Të fala iu ka bërë Aliu! Ai ka vdekur në duart e mia. Fjalët e tij të fundit ishin: "Kosova Republikë!" dhe "Të fala shokëve!", na tha Sabri Kiçmari pastaj. Në atë moment asnjëri prej neve nuk mundi t'i fsheh lotët. Aliu ishte idoli ynë dhe e donim sikur ta kishim vëlla. Sabriu vazhdoi më tutje të tregonte se si kishte rënë dëshmori ynë: Sapo ishin ndarë nga ne, ata qenë tërhequr në drejtim të daljes së qytetit. Policia u ishin vërsulur si të tërbuar pas.

Safeti e kishte mbajtur lart flamurin e shpalosur, prandaj policët i kishin ndjekur. Nga aty kishin ikur në drejtim të Mirocit, me qëllim që të strehoheshin diku në mal. Mirëpo policia u ishte vërsulur mbrapa dhe i kishte ndjekur deri atje. Në hyrje të fshatit Shtedim kishin ardhur mbrapa me shpejtësi dy-tri makina policie, të cilët kishin shtënë me automatikë. Me Sabriun e Safetin kishin qenë edhe shtatë-tetë nxënës, në mos më shumë e ndër ta edhe Nazmi Ajeti, i cili deri atëherë ka vepëruar legal për lirinë e Kosovës. Pasi e kishin vërejtur se policia nuk hiqte dorë, por i ndiqte edhe më tej, të gjithë kishin hyrë në një arë me grurë. Policët kishin gjuajtur me armë zjarri në drejtimin e tyre. Sabriu dhe Aliu kishin qenë të detyruar t'ua kthenin gjuajtjen në vetëmbrojtje. Ndërkohë policët shqiptarë ishin barrikaduar pas autoblandave dhe kishin vazhduar të gjuanin pandërprerë. Një nga rafalët vdekjeprurës e kishte qëlluar Aliun tonë në pjesën e poshtme të barkut. Ai në fillim nuk e kishte vërejtur. Nga ngjyra e verdhë që i kishte marrë fytyra, Sabriu e kishte pyetur:

"Ali, çka u ba bre?"

"Nuk e di Sabri, po diçka trupi m'u nxe", ia kishte kthyer ai. Dhe vetëm atëherë Aliu e kishte vërejtur se e kishte marrë plumbi dhe

përnjëherë ishte rrezuar përtokë. Sabriu me Nazmiun iu kishin afruar dhe e kishin vërejtur se ai ishte plagosur rëndë. Ai ishte përmbajtur edhe pse kishte pasur gjakderdhje të madhe. Dhe pasi nuk kishte mundur të lëvizte më, u kishte thënë atyre, se ata duhet të iknin dhe ta linin atë aty, duke mos rrezikuar më gjatë. Këta të dy nuk kishin pranuar në asnjë mënyrë.

Pas plagosjes së Aliut, Sabriu ia kishte dhënë Nazmiut automatikun e tij. Nazmiu ishte munduar t'i mbrojtë ata të dy, deri sa Sabriu e kishte mbajtur për krahu Aliun dhe e kishte tërhequr disa dhjetëra metra. Papritmas Nazmiut nuk i kishte funksionuar më automatiku, ngase i kishte rënë karikatorit. Kot ishte munduar ta gjejë në arë të grurit. Sabriu e kishte thirrur Nazmiun të kthehej, sepse rreziku të qëlllohej edhe ai nga plumbat e armikut ishte ende i madh. Edhe njëherë ishin munduar së bashku ta tërheqin Aliun, por ai i kishin ndaluar dhe lutur ta linin aty, sepse nuk mundej më, ngase kishte humbur shumë gjak. Edhe ata e kishin vërejtur se Aliu ishte dobësuar. Në atë moment ai u kishte thënë: "Automatikun mos ma lini këtu, nuk dua të bjerë në duar të armikut!", pastaj kishte brohoritur: "Kosova Republikë!" dhe "Të fala shokëve!". Sabriu e kishte hequr pallton e vet dhe e kishte mbuluar. Ai i kishte mbyllur sytë dhe në duart e shokëve e kishte lënë frymën e fundit.

Me dhembje të madhe shpirtërore ishin detyruar ta lënë Aliun prapa e të tërhiqeshin. Ndryshe nuk kishin pasur si të vepronin, sepse policët ishin vërsulur mbrapa duke gjuajtur. Nga rafalët e plumbave, gruri kishte rënë përtokë. Nazmiu ishte bashkuar me nxënësit, të cilët kishin hyrë në një oborr të një shtëpie për t'u fshehur. Ata kishin qëndruar aty, derisa kishte pushuar zjarri i armëve. E pasi kishin marr guximin të dilnin jashtë, kishin marr drejtimin e Ballocit dhe ishin larguar nga aty. Ndërsa Sabriu ishte bashkuar me Safetin, ku me shumë mundime kishin arritur të hynin në një mal dhe ishin strehuar afër një përroske. Ndërkohë regjimi kishte rrethuar me tanke e njësi speciale Mirocin, Shtedimin dhe fshatrat përreth.

Pasi që na tregoi se si kishte ndodhur e tërë ajo ngjarje, Sabriu tha se kishte ardhur vendimi nga lart: Ne duhej të largoheshim nga Atdheu! Armiku ishte tërbuar shumë dhe nuk kursente asgjë për të na zënë. I hidhur qe tregimi i rënies së Aliut, por edhe lajmi për largim nuk qe më pak i hidhur për ne. Në atë kohë të arratisesh nga Atdheu ishte gati sikur të vdisje.

(Fund)



# A i "ndanë rrugët" Presidenca, Qeveria dhe Kuvendi?



ose kryetari janë jashtë vendit në vizita zyrtare)", ka thënë ai për Radion Evropa e Lirë.

## Presidentja Osmani, jashtë kalkulimeve zgjedhore të Kurtit

Zgjedhjet e rregullta parlamentare në Kosovë pritet të mbahen vitin e ardhshëm kur edhe i përfundon mandati qeverisës së drejtuar nga Albin Kurti.

Ditët e fundit në Kosovë është diskutuar për mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme, por partitë politike nuk arritën dakordim për mënyrën se si duhet shkuar në zgjedhje. Sipas drejtoreshës së Lëvizjes Fol, Mexhide Demolli, kalkulimet politike të kësaj fushate zgjedhore kanë prekur edhe raportet ndërmjet krerëve institucionalë. "Tashmë kanë filluar kalkulimet politike edhe për pozitat e ardhshme. Të mos harrojmë se mandati i presidentes është pesëvjeçar, pra një vit më shumë sesa i Qeverisë dhe, si duket, kryeministri aktual tashmë ka filluar t'i bëjë përllogaritjet e tij dhe presidentja aktuale nuk i hyn në këto kalkulime, duke qenë se kjo e fundit edhe i ka dalë kundër në disa veprime", thotë Demolli.

Ashtu si Demolli, edhe analisti politik Artan Muhaxhiri thotë se presidentja Osmani nuk është më pjesë e kalkulimeve politike të Kurtit. "Shpërthimi u përshpejtua nga takimi Kurti - Krasniqi, ku u bisedua për mundësinë e zgjedhjeve të reja. Gjithsesi që në takime të tilla edhe posti presidencial është segment themelor i negociatave dhe kornizave të marrëveshjeve eventuale. Pasi presidentja Osmani 'nuk gjendej në tavolinë, ajo ishte pjesë e menysë'", thotë ai. Për pretendimet e ngritura nga Demolli dhe Muhaxhiri, Radio Evropa e Lirë ka tentuar të marrë një koment nga kabineti i presidentes Osmani, ai i kryeparlamentarit Konjufca, kryeministrit Kurti dhe i ministres Gërvalla, por deri në publikimin e këtij teksti ata nuk janë përgjigjur. Lista Guxo, e cila ishte themeluar nga presidentja Osmani së bashku me ministren Gërvalla, kishte garuar në një listë të përbashkët me Lëvizjen Vetëvendosje në zgjedhjet e vitit 2021.

Guxo, së bashku me Lëvizjen Vetëvendosje, kishin marrë mbi 50 për qind të votave.

Rezultatet i siguruan Vetëvendosjes 58 deputetë, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) 19 deputetë, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) 15 deputetë, Listës Serbe 10 deputetë dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) 8 deputetë.

Qeveria Kurti 2 u votua më 22 mars të vitit 2021, ndërsa Vjosa Osmani u zgjodh presidente pak ditë më vonë, më 4 prill 2021.

Prishtinë, 31 maj - Rugëtimit të përbashkët politik të presidentes Vjosa Osmani, kryetarit të Kuvendit Glauk Konjufca, kryeministrit Albin Kurti dhe zëvendëskryeminstres Donika Gërvalla duket se po i vjen fundi, sipas njohësve të çështjeve politike në vend, Artan Muhaxhiri dhe Mexhide Demolli.

Afërsia e presidentes Osmani me ndërkombëtarët, si dhe kalkulimet politike parazgjedhore të kryeministrit Kurti, po vlerësohen si disa nga arsyt që e kanë shkaktuar këtë ndarje, e cila filloi të bëhej publike në javët e fundit.

Presidentja Vjosa Osmani tha se nuk u konsultua për letrën që ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, ia kishte dërguar presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Theodoros Rousopoulos, më 16 maj.

Në këtë letër, Gërvalla, e cila njëherësh është edhe kryetare e partisë Guxo, parti të cilën e kishte themeluar Osmani para se të bëhej presidente, ka thënë se Qeveria e Kosovës është duke përgatitur një draft-statut për Asociacionin, të cilin është zotuar ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese deri në fund të majit. Dërgimi i draft-statutit në Gjykatën Kushtetuese kishte qenë kusht i disa vendeve anëtare, duke përfshirë edhe Francën dhe

Gjermaninë, për ta përfshirë anëtarësimin e Kosovës në agjendën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 17 maj.

Por, pavarësisht prej gjithë kësaj, Kosova dështoi të përfshihej në agjendën për anëtarësim në Këshill të Evropës, dhe letra u konsiderua e vonshme.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, më 29 maj tha se mosinformimi i presidentes ishte i paqëllimshëm pasi ajo ishte në vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Për shkak të largësisë, jo çdo hollësi e cila ndryshonte çdo minutë në ditën e votimit që e kishim nga ana e Këshillit të Ministrave për Këshill të Evropës, mund të ndahet dhe koordinohet", ka thënë Konjufca në një deklaram për gazetarë.

Këtë deklaram të kryeparlamentarit Konjufca, presidentja Vjosa Osmani e quajti 'qesharak', pasi që, sipas saj, largësia nuk ka qenë problem. "Të thuhet që kjo në çfarëdo mënyre paska pasur të bëjë me largësinë, për mua është diçka që nuk dua ta besoj që dikush e thotë, sepse nuk ka fare të bëjë me realitetin dhe tregon që në njëfarë mënyre, po tentohet që për këtë moskoordinim për një çështje kaq kapitale, faji të lihet te Presidenca", ka thënë Osmani në një deklaratë për portalin "Ekonomia Online".

## "Tragjikomedia me letrën në Këshillën e Evropës e ndezi fitilin për eksplodimin final"

Artan Muhaxhiri, analist i çështjeve politike, thotë për Radion Evropa e Lirë se thyerja në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentes Vjosa Osmani ka ndodhur për shkak të mospajtimeve se kush duhet ta përgatisë draftin për Asociacionin. Kurti kishte deklaruar se draftin duhej ta shkruajë ai së bashku me ministrin e tij për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiç, dhe atë të Vetëqeverisjes Lokale, Elbert Krasniqi, por ashtu nuk mendoi presidentja Osmani. "Çarja e parë e rëndësishme nisi në shtatorin e 2023-s, kur presidentja Osmani e dha idenë që drafti i Asociacionit të krijohej bashkë nga institucionet e Kosovës dhe ShBA-ja. Pastaj vazhdoi me identifikimin publik të presidentes nga përfaqësuesit amerikanë si aleatja e tyre kryesore në Kosovë dhe balancuesja e qëndrimeve radikale të kryeministrit", thotë Muhaxhiri. Sipas tij, "tragjikomedia me letrën në Këshillën e Evropës e ndezi fitilin për eksplodimin final". "Sabotimi që iu bë duke e injoruar në një momentum kritik, ishte mesazhi i qartë për të", vlerëson ai.

Drejtoresha e Lëvizjes Fol, Mexhide Demolli, përmend moskoordinimin me faktorin ndërkombëtar për aksionet në veri, si një ndër shkaktarët e prishjes së raporteve. "Rrugët mes presidentes dhe kryeministrit në këtë rast kanë filluar nga koha kur kryeministri, pa ndonjë koordinim me aktorët ndërkombëtarë që janë në vendin tonë, filloi aksione të ndryshme për shtrirjen e sovranitetit në veri të vendit", thotë ajo.

Ashtu si Muhaxhiri, edhe ajo pohon se afërsia e presidentes me ndërkombëtarët ka ndikuar edhe më shumë. "Ne shihnim se në shumë raste takimet e ndryshme, qoftë të ambasadorëve apo edhe delegacioneve të ndryshme, mbaheshin vetëm me presidenten duke u injoruar kështu kryeministri", thekson ajo. Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar kabinetet e Osmanit, Kurtit dhe Gërvallës për të marrë përgjigje nëse kanë ndryshuar raportet mes tyre, por deri në publikimin e këtij teksti nuk ka marrë përgjigje.

Ndërsa nga kabineti i kryetarit të Kuvendit, Ilir Kërçeli ka mohuar të ketë ndonjë mospajtim mes presidentes Osmani dhe kryeparlamentarit Konjufca. "Raportet me presidenten janë shumë të mira. Kryetari ka takime të rregullta javore me presidenten (përfashto ato ditë kur presidentja



## Ankandi i parë solar prej 100 MW, investim në vlerë mbi 70 milionë euro

PRISHTINË, 31 MAJ - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka bërë me dije se kanë nënshkruar kontratën e zhvillimit të projektit të ankandit të parë solar prej 100 MW me konsorciumin "Orllati", të përbërë nga Orllati Groupe nga Zvicra, Holdigaz nga Zvicra, ZPV nga Gjermania dhe Jaha Solar nga Kosova. Rizvanolli në "Facebook" ka shkruar se ky investim prej mbi 70 milionë eurosh

nuk do të ishte i mundur pa iniciativën e vullnetin e Avni e Destan Orllatit, ndër ndërmarrësit më të suksesshëm e të respektuar në Zvicër. "Shembujt si ky demonstronjë më së miri se sa me fat është shteti i Kosovës që ka një mërgatë të suksesshme e të fuqishme, të gatshme për të kontribuar në zhvillimin e vendit dhe marrëdhëniet mes vendlindjes dhe shteteve ku jetojnë. Me një

qeverisje të pastër, ambient të të bërit biznes gjithnjë më fer, e me zhvillim të shpejtë ekonomik, Kosova po bëhet vend ku mërgata jonë, por jo vetëm, po rikthen besimin për të investuar. Kosova është e tyre po aq sa e jona, dhe është koha që ata Kosovën ta shohin edhe si vend të sigurt e tërheqës për investime, me përfitime të dyanshme", ka shkruar ajo.



## Dogana e Kosovës pranon 1 360 aplikime për pozitat e reja doganore, procesi drejt përfundimit

PRISHTINË, 31 MAJ - Dogana e Kosovës më 7 mars të këtij viti kishte shpallur konkursin për rekrutim të oficerëve doganorë. Konkursi, që ka qenë i hapur deri më 22 mars, kishte nxitur pakënaqësi te qytetarët për shkak të kriterit të moshës që kishte parashtruar Dogana në këtë konkurs. Pika 3 e këtij konkursi thoshte se aplikuesi duhet të jetë i moshës 18 deri në 30 vjeç.

E lidhur me këtë konkurs nga Dogana e Kosovës kanë thënë për "Telegraf"-in se procesi është transparent dhe po zhvillohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara. "Konkursi për doganierë u shpall më 07.03.2024 për të gjithë aplikantët që përmbushin kriteret e përcaktuara në shpallje. Kriteri i moshës ka qenë një prej pikave të përmendura në konkurs dhe është përfshirë me qëllim që të sigurohet një proces përzgjedhës sa më i drejtë dhe i balancuar sipas nevojave të Doganës", ka thënë Adriatik Stavileci, zëdhënësi i Doganës së Kosovës.

Stavileci për "Telegraf"-in tha se gjatë periudhës së aplikimit kanë pranuar mbi 1 mijë e 300 aplikime. "Gjatë periudhës së aplikimit kemi pranuar një numër të madh aplikimesh. Numri i saktë i aplikantëve që kanë aplikuar për këtë konkurs ka qenë 1360. Ky interes i lartë tregon për nevojën dhe dëshirën e qytetarëve për të kontribuar në shërbimin doganor të Kosovës", u shpreh Stavileci.



Ai më tej shtoi se procesi i përzgjedhjes është rigoroz dhe është duke u kryer nga një komision i posaçëm, duke marrë parasysh të gjitha kriteret dhe kërkesat e vendosura në konkurs. "Në përfundim të këtij procesi, dogana do ta bëjë publik listën e kandidatëve që përmbushin të gjitha kërkesat dhe standardet e

nevojshme për të qenë pjesë e fazës së ardhshme. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve pritet të përfundojë javën e ardhshme", tha Stavileci.

Në shpalljen e konkursit tek përshkrimi i punës thuhet se "oficerët doganorë ushtrojnë kontrollin e mallrave, udhëtarëve, mjeteve, aeroplanëve, mbrojnë

Kosovën nga kërcënimet e terrorizimit, kontrabandës, mashtrimit, krimin të organizuar dhe parandalojnë hyrjen e paligjshme të narkotikëve dhe mallrave të falsifikuara, duke zbatuar drejt udhëzimet ligjore dhe procedurat e parapara doganore, për ta arritur misionin dhe objektivat e përcaktuara nga

Dogana e Kosovës. Dogana e Kosovës funksionon 24 orë në ditë, 365 ditë në vit. Oficerët doganorë punojnë me orare të ndryshme, duke përfshirë ndërrimin e natës, fundjavën, festat zyrtare dhe punën jashtë orarit, nëse është e nevojshme, në çdo vend në gjithë Kosovën".

## 12,3 milionë euro investime në komunën e Vushtrrisë

VUSHTRRI, 31 MAJ - Deri më tani Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në komunën e Vushtrrisë ka investuar një vlerë prej 12 356,088 eurosh në të gjitha kategoritë. Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka theksuar se për vitin 2021, 2022, 2023 përmes

Programit për Pagesa Direkte / Subvencione, fermerët e komunës së Vushtrrisë janë përfitues të vlerës prej rreth 7,9 milionë eurosh. Ndërkaq, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese përmes projekteve të granteve, vlera e

deritanishme është rreth 4,1 milionë euro. "Rreth 200 000 euro është vlera e investimit në ngritjen e kapaciteteve të sistemit të ujitjes, kurse me 191 692 euro janë kompensuar për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore", ka shkruar Peci në "Facebook".





# Si e ndryshoi historinë amerikane ylli i filmave për të rritur?

Donald Trump është dënuar për falsifikimin e dokumenteve dhe fshehjen e pagesave për yllin e filmave për të rritur Stormy Daniels. Me këtë, ai u bë ish-presidenti i parë amerikan që u dënua në procedurë penale. Dënimi është caktuar për 11 korrik, por avokatët mbrojtës ka të ngjarë të apelojnë vendimin.

Kjo, nga ana tjetër, nuk do të thotë se 77-vjeçari nuk mund të jetë kandidati i republikanëve në zgjedhjet presidenciale të nëntorit. Ai tani po përpiqet të përfitojë nga vendimi dhe të përfitojë financiarisht për fushatën ndërsa tashmë në orët e para pas vendimit, dukej se ia kishte dalë.

Juria e Gjykatës së Qarkut në Manhattan mori një vendim dhe e shpalli fajtor ish-presidentin amerikan për 34 akuza në një gjyq penal për fshehje të pagesave monetare.

## Kush është Stormy Daniels

Stephanie A. Gregory Clifford (lindur Stephanie A. Gregory; 17 mars 1979), e njohur profesionalisht si Stormy Daniels, është një aktore, regjisorë dhe ish-stripteiste e filmave pornografik amerikan.

Ajo ka fituar shumë çmime të industrisë dhe është anëtare e Hall

avokatin e tij, Michael Cohen – këste mujore prej 35 mijë dollarësh, të destinuara për Stormy Daniels, për ta parandaluar atë të fliste publikisht në lidhje për marrëdhënien seksuale me Trumpin, pak para zgjedhjeve të vitit 2016.

Trump tha se nuk dinte asgjë për rimbursimin e Cohenit dhe mohoi të kishte kryer marrëdhënie seksuale me atëkohë, 41-vjeçaren. Gjykatësi Juan Mercan vendosi që dënim të shqiptohet më 11 korrik. Mercan mund ta dënojë Trumpin me kusht ose deri në katër vjet burg për secilën akuzë. Ish-presidenti amerikan do të qëndrojë për momentin jashtë burgut, në pritje të dënimit.

## Manovër për mbështetësit

Pak çaste pasi juria e New Yorkut dha vendimin e fajësisë, fushata e Trumpit nisi mbledhjen e fondeve në internet.

Trump e ndoqi duke i 'dhënë zjarr' në llogarinë e tij të Truth Social, duke e quajtur veten "i burgosur politik" dhe duke dërguar një apel të ri për mbledhjen e fondeve për mbështetësit e tij.

"Sapo jam dënuar në një gjyq politik të montuar për gjueti shtrigash. Nuk bëra asgjë të keqe! Por, me mbështetjen tuaj në këtë moment



milionë dollarë që deri më tani ka mbledhur kundërshtari aktual Joe Biden.

"Me vendimin, mendoj se do ta lironi plotësisht popullin. Ata që ishin mbështetës do të japin më shumë. Dhe ata që janë lënë anash do të vijnë për t'u mbledhur rreth asaj që ata e shohin si drejtësi", tha Matthew Bartlett, strateg republikan dhe ish-përfaqësues i administratës së Trumpit.

## Fondet e fushatës

Mbështetësit e Trumpit duket se e kanë dëgjuar thirrjen e tij.

WinRed, platforma kryesore e donacioneve në internet për republikanin dhe shumë republikanë të tjerë, nuk funksionoi për një kohë të enjten në mbrëmje për shkak të një ngarkese të madhe donatorësh. Faqja e internetit e Trumpit më pas i drejtoi donatorët në një platformë tjetër.

Trump ka përjetuar vazhdimisht sukses të madh kur bëhet fjalë për mbledhjen e fondeve falë problemeve ligjore.

Ai mblodhi gati katër milionë dollarë në WinRed kur u padit më shumë se një vit më parë, më pas e kaloi atë total ditore në muajin gusht, kur u rrëmbye pasi u përball me një raund të ri akuzash në Georgia.

Fushata e tij është përpjekur vazhdimisht të fitojë para nga gjyqi, duke sulmuar Prokurorin e Qarkut të Manhattanit, Alvin Bragg, duke u

ankuar para mbështetësve se ai humbi kohën e fushatës dhe duke sugjeruar se ai ishte heshtur pasi u gjobit nga gjyqtari Juan Mercan.

## Frika nga trazira

Reuters raporton se mbështetësit e Trumpit në rrjetet sociale po bëjnë thirrje për trazira, revolucion dhe hakmarrje të dhunshme.

Agjencia raporton se pas vendimit, mbështetësit e Trumpit janë përgjigjur me mesazhe në faqet e internetit të lidhura me ish-presidentin, në të cilat bëjnë thirrje për dhunë.

Siç shtohet, disa mbështetës të ish-presidentit amerikan kanë bërë thirrje për sulme ndaj anëtarëve të jurisë, ekzekutimit e gjyqtarit Juan Mercan ose luftë të drejtpërdrejtë civile dhe rebelim të armatosur.

Të gjitha mesazhet e para nga reuters bënin thirrje për dhunë ose rebelim, por shumica nuk përmbushnin standardin ligjor për një kërcënim kriminal, i cili zakonisht kërkon prova që komenti pasqyron një qëllim të qartë për të vepruar ose futur frikë, në vend që thjesht të sugjeronte një rezultat të tmerrshëm.

Një zëdhënës i rrjetit Trump TruthSocial tha në lidhje me artikullin e reuters se ai ishte një "shkrim manipulues, i remë, shpifës dhe transparentisht budalla" dhe se ai u botua "thjesht për inat politik".

## Trump mund të jetë kandidat presidencial

Edhe pse pothuajse të gjithë tani pyesin nëse Trump, i cili është dënuar në procedurat penale, mund të kandidojë për president, përgjigja është shumë e thjeshtë – po.

Sipas Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, një kandidat për president duhet të jetë së paku 35 vjeç, të jetë shtetas amerikan i lindur në atë vend dhe të ketë jetuar atje për të paktën 14 vjet përpara se të kandidojë për postin. Kur bëhet fjalë për dënime penale ose procedime kundër një kandidati të mundshëm, Kushtetuta amerikane nuk e pengon atë.

Edhe pse është pothuajse e sigurt që Trumpi do të apelojë vendimin, i cili do të zgjasë më tej të gjithë procesin, ndoshta edhe pas zgjedhjeve presidenciale, ka disa opsione për gjyqtarin.

Gjatë vendosjes së dënimit, gjyqtari Mercan do të ketë parasysh faktin se është 77 vjeç, se nuk ka qenë i dënuar më parë dhe nëse do të shkelë urdhrat e gjykatës.

Dënimi mund të jetë gjobë, me kusht ose mundësisht me burgim. Një dënim me burg është i mundur, por analistët besojnë se nuk ka gjasa në këtë rast dhe se gjyqtari do të shmangë dërgimin e ish-presidentit në burg. /Telegrafi/



of Fame "NightMoves", Hall of Fame "AVN" dhe Hall of Fame "XRCO".

Daniels u përfshi në një mosmarrëveshje ligjore me presidentin e SHBA-së, Donald Trump në vitin 2018.

Avokati i Trumpit, Michael Cohen, thuhet se e pagoi 130 mijë dollarë ish-aktoren për t'ia mbyllur gojën rreth aferës seksuale që ajo thotë se e kishte me 77-vjeçarin në vitin 2006.

Stormy Daniels ka përshkruar atë që ndodhi më pas në dhomën e hotelit gjatë seancave gjyqësore.


## Fajtor

Një juri prej 12 anëtarësh po diskutonte nëse Trump ishte fajtor për falsifikimin e dokumenteve të biznesit në lidhje me fshehjen e pagesave sekrete për yllin e filmave për të rritur Stormy Daniels.

Prokurorët kaluan javë të tëra duke u përpjekur të provonin se ish-lideri amerikan pagoi me vetëdije ish-







Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Sonte Dortmundi dhe Reali kërkojnë trofeun e Ligës së Kampionëve

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 31 MAJ** - Borussia Dortmundi dhe Real Madridi sonte nga ora 21:00 përballen në "Wembley" në finalen e madhe të Ligës së Kampionëve për edicionin 2023/2024. Dortmundi me fitore do t'i jepte fund pritjes 27-vjeçare për këtë trofe, ndërsa do të ishte i dyti në histori të klubit gjerman, kurse "Los Blancos" përpiqet ta gdhendë në Ligën e Kampionëve për herë të 15-të. Djemtë e drejtuar nga Edin Terzić triumfuan kundër Paris Saint-Germaini për ta rezervuar biletën e finales, kurse djelmohat e Carlo Ancelotti ua mohuan kundërshtarëve të ardhshëm një finale gjermane ndaj Bayern Munchenit, të cilën e eliminuan falë një rikthimi senzacional. Trajneri i Borussia Dortmundit, Edin Terzić, i intervistuar nga

faqja e UEFA-s, ka thënë se kundërshtari është i fortë, por është optimist se skuadra e tij mund ta fitojë ndeshjen. "Ne kemi luajtur shumë mirë deri më tani në Ligën e Kampionëve, duke e fituar me meritë të drejtën për të shkuar në këtë finale. Tashmë ne përballemi me një ekip shumë të fortë që e ka pasur shpesh këtë përvojë, por ne e dimë se një në 10 ndeshje ndaj Real Madridit mund ta fitojmë. Shpresoj që kjo të jetë ajo e duhura", ka thënë Terzić. "Ndaj tyre mund të pësojmë shumë humbje, por në një ndeshje të vetme, në 90 minuta ose në 120 minuta dhe penallti, ne jemi të aftë të mposhtim çdo kundërshtar në botë. Natyrisht që më duhet të fitoj ende përvojë në disa detaje. Por, gjithashtu, përpiqem t'i shfrytëzoj më shpesh njerëzit që e kanë pasur këtë përvojë, përpara se të bëj gabime që mund të ishin



### Formacionet e mundshme:

Borussia Dortmund: Kobel; Ryerson, Hummels, Schlotterbeck, Maatsen; Sabitzer, Can; Sancho, Brandt, Adeyemi; Fullkrug.

Real Madrid: Courtois; Carvajal, Rudiger, Nacho, Mendy; Valverde, Camavinga, Kroos; Bellingham; Rodrygo, Vinicius Junior.

shmangur në fazën përgatitore", ka shtuar Terzić. Në pikëpyetje për Borussia

Dortmundin në këtë ndeshje është Sebastien Haller, kurse Realit i mungojnë David Alaba,

Aurelien Tchouameni, kurse Andriy Lunin është i sëmurë me grip, por lajm i mirë është se Thibaut Courtois është i gatshëm për këtë finale të madhe. Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, para finales ka thënë se skuadra e tij është gati për të luajtur në lojën më të bukur të vitit. Ai ka thënë se Dortmundi është një kundërshtar i vështirë dhe se me meritë është në finale. "Jemi vërtet të lumtur që do të luajmë edhe një finale. Do të vijë nervozizmi, por synojmë të vijë sa më vonë të jetë e mundur. Duhet ta shfrytëzojmë këtë moment, këtë ndeshje të madhe, më të mirën e vitit dhe më të bukurën për t'u përjetuar. Kemi shumë besim. Nuk mendojmë për atë se a jemi favoritë. Duhet të luajmë ndaj ekipit që arriti sukses të madh duke eliminuar PSG-në, Atletico Madridin. Lojtarët e ekipit rival kanë shfaqur përkushtim", ka thënë Ancelotti.

## Behar Maliqi pensionohet nga futbolli

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 31 MAJ** - Behar Maliqi, një prej lojtarëve më të mirë në vitet e fundit në futbollin e Kosovës, ka vendosur që t'i japë fund karrierës si futbollist. Ai gjatë karrierës 20-vjeçare ka luajtur për shumë klube të Kosovës, derisa një kohë ishte pjesë edhe e futbollit në Shqipëri. Maliqi ka

thënë se po tërhiqet nga futbolli i përmbushur, derisa momentin më kulminant e vlerëson të qenit pjesë e Përfaqësueses së Kosovës. "Të dashur familjarë dhe miq, sot dua t'ju informoj për një vendim shumë të rëndësishëm. Pas një karriere të gjatë prej më shumë se 20 vitesh në futboll, kam vendosur të tërhiqem nga futbolli aktiv. Gjatë kësaj periudhe si lojtar aktiv kam fituar shumë. Kam përjetuar

momente të paharrueshme, kam krijuar miqësi të shumta dhe kujtime që do t'i mbaj mend gjithmonë. Veshja e fanellës së Përfaqësueses së Kosovës ishte një ndër arritjet më të mëdha, ishte nder dhe privilegj ta përfaqësoje vendin tim", ka thënë Maliqi. "Dua të falënderoj në radhë të parë familjen time dhe shoqërinë për mbështetjen gjatë gjithë karrierës sime. Po ashtu, dua t'i falënderoj

të gjithë ata që kanë qenë pjesë e karrierës sime: të gjithë klubet që ma kanë besuar fanellën e tyre (KF Feronikeli 74, KF Prishtina, KF Llapi, KF Malisheva, FK Partizani, KF Fushë Kosova, KF KEK-u, KF Aeroporti), të gjithë trajnerët, të gjithë bashkëlojtarët dhe, patjetër, tifozët për përkrahjen. Faleminderit edhe njëherë për të gjitha emocionet", ka shtuar Maliqi.



## Ballkani 'blindon' trajnerin Daja dhe mbrojtësin Jashanica



### "Epoka e re"

**SUHAREKË, 31 MAJ** - Skuadra kampione dhe fituese e Kupës në futboll, Ballkani, ka arritur t'i "blindojë" me kontrata të reja trajnerin Ilir Daja dhe mbrojtësin Bajram Jashanica. Trajneri nga Shqipëria, që është ndër më meritoret për sukseset e klubit nga Suhareka, do të jetë pjesë e Ballkanit

edhe për dy vjet të tjera. "Ashtu siç kemi bërë të ditur në fund të muajit shkurt, profesor Ilir Daja do të jetë pjesë e jona së paku edhe për dy vjet. Të gjitha planet e klubit për këtë periudhë kohore lidhen me projektin e përbashkët me trajnerin tonë. Çdo formë tjetër që po merr jehonë në media, mbetet thjesht spekulim, me qëllime dashakeq ndaj klubit. Na priftë e mbara. Shihemi në Ligën e Kampionëve",

thuhet në njoftimin e klubit kampion. Për dy vjet kontratën e ka rinovuar edhe mbrojtësi Bajram Jashanica. "Një prej aseteve tona të çmueshme të sukseseve historike, vazhdon me kampionët edhe për 2 vjet. 'Muri' ynë i mbrojtjes, Bajram Jashanica, nënshkruan deri më 2026. Klubi i uron suksese futbollistit, drejt objektivave tona të përbashkëta", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

## 'Alfa-I', fituese e turnirit tradicional 'Demush Mavraj'

**ISTOG, 31 MAJ** - Ekipi "Alfa-I" është fitues i edicionit të 25-të në turniri tradicional në futboll të vogël "Demush Mavraj". Turniri që organizohet në nderim të dëshmorit të kombit dhe arsimtarit të Edukatës Fizike, Demush Mavraj, solli ndeshje

mjaft të forta dhe interesante. Finalja është organizuar në vendlindjen e ish-ushtarit të UÇK-së, Saradran, ku nuk mungoi programi artistik, thjesht gjithçka ishte e përkryer ashtu siç ishte edhe vepra dhe kontributi i arsimtarit në edukimin e

brezave të rinj dhe çlirimin e Kosovës. Në finalen e madhe u përballen ekipi "Alfa I" dhe ekipi "FC. Meriton Berisha", ku fituese doli "Alfa I" me rezultat 3-1. Lojtari më i dalluar është shpallur Drilon Maxharraj, kurse portieri më i dalluar Meriton Berisha.





## Muriqi: Ndhimova sa munda, sezoni tjetër do të shkojë më mirë

**MALLORCA, 31 MAJ** - Sezoni në La Liga tashmë ka përfunduar dhe Mallorca e Vedat Muriqit arriti ta siguronte mbijetesën tek në xhiron e parafundit. E sulmuesit nga Kosova ka reaguar në rrjetet e tij sociale lidhur me edicionin e fundit. Ai foli për sezonin jo të mirë, teksa

përmendi edhe finalen e Kupës së Mbretit që e humbi ndaj Athletic Bilbaos. "Ne përfundojmë një sezon plot emocione të ndryshme. Shumë i lumtur që kam arritur qëndrueshmërinë dhe që Mallorca është në kategorinë e parë edhe për një sezon tjetër,

megjithëse do të donim ta arrinim duke ju bërë të vuani më pak. Lëndimi im më ka shënuar një pjesë të madhe të sezonit, i cili, në nivel personal, nuk ka qenë ajo që kam dashur, por gjithmonë jam përpjekur t'i bashkohem skuadrës dhe të jap gjithçka për këtë klub dhe këtë

simbol. Nuk mund t'i them lamtumirë sezonit pa veçuar finalen e kupës në Sevilje. Ajo që përjetuam atë ditë ishte unike dhe duhet të jemi krenarë që arritëm në finale. Tani është koha për të pushuar, por me të vërtetë dua që sezoni i ardhshëm të jetë më i mirë.



## Martin Nemeć, përzgjedhës i ri i Kosovës në volejboll

**PRISHTINË, 31 MAJ** - Federata e Volejbollit e Kosovës e ka emëruar sllovakun Martin Nemeć përzgjedhës të ri të Përfaqësueses së Kosovës në Volejboll. FVK-ja ka bërë një hap të rëndësishëm për përforcimin e ekipit përfaqësues dhe rritjen e nivelit të volejbollit në vend. Me një karrierë të gjatë dhe të suksesshme si lojtar dhe trajner, Nemeć sjell me vete një përvojë të gjerë ndërkombëtare. Ai ka luajtur për disa prej ekipeve më të mira në Evropë dhe ka trajnuar ekipe në ligat më të njohura të kontinentit. Përveç kësaj, ai është njohur për aftësitë e tij taktike dhe për qasjen e tij inovative ndaj stërvitjes dhe zhvillimit të lojtarëve. "Jam i nderuar dhe i emocionuar që jam emëruar përzgjedhës i Kombëtares së Kosovës në Volejboll. E shoh një potencial të madh në këtë ekip dhe jam i përkushtuar të punoj fort për t'i



arritur sukseset që meriton ky vend", ka thënë Nemeć pas emërimit. Ky emërim shënon një hap të ri për zhvillimin e sportit të volejbollit në Kosovë dhe

Federata shpreson që me përvojën dhe udhëheqjen e Nemeć, Kosova do të arrijë rezultate të shkëlqyera në garat e ardhshme ndërkombëtare.

## Dallasi shpallet kampion në Konferencën e Perëndimit

**MINNEAPOLIS, 31 MAJ** - Dallas Mavericks u kualifikua në finalen e madhe të NBA-s pasi mposhti Minnesota Timberwolvesin me rezultat 124:103, duke fituar me rezultat të përgjithshëm 4-1 finalen e Konferencës Perëndimore. Dallasi pati një fillim fenomenal në këtë ndeshje, e cila u luajt në "Target Center" në Minneapolis dhe tashmë pas çerekut të parë kishte një avantazh prej 16 pikësh. Vlen të theksohet se sloveni i shkëlqyer Luka Dončić shënoi 20 pikë në çerekun e parë. Minnesota ishte e tronditur, asgjë nuk po shkonte siç duhej, kështu që deficitin vetëm sa u rrit dhe pjesa e parë përfundoi me rezultatin 69:40 për Dallasin. Skuadra vendase tregoi dhembët në pjesën e dytë në të cilën ishin shumë më mirë, por e gjithë kjo nuk mjaftoi për asgjë. Në fund të lojës



ata arritën ta zbusnin sikletin, ndërsa Dallasi mund të fillonte të festonte pas fitores 123:103. Mavericksi u çua në finalen e madhe nga Dončić dhe Kyrie Irving. Të dy shënuan nga 36 pikë, ndërsa sloveni shtoi edhe 10 kërcime. Karl-

Anthony Towns ishte i vetmi në formë të Minnesota me 28 pikë dhe 12 kërcime. Dallasi do të luajë kundër Boston Celticsit në finalen e madhe të NBA-s dhe ndeshja e parë e serisë do të luhet mëngjesin e së premtes së ardhshme.

### SHKURT

#### Zhegrova: Ka ardhur momenti të transferohem në klub të madh

Edon Zhegrova zhvilloi sezonin e jetës në Francë, ku me 12 gola dhe 10 asistime ishte një nga lojtarët më të mirë të Lille. Këto shifra dhe paraqitja e tij pritet ta largojnë Zhegrovën gjatë verës nga klubi francez. Një fakt që e ka pranuar edhe vetë lojtari nga Kosova, duke shprehur dëshirën e tij për t'u transferuar në një ekip më të madh. "Mendoj se kam dhënë më të mirën time te Lille. Mendoj se tani ka ardhur momenti të transferohem në një klub më të madh", u shpreh Zhegrova për Oxygen. Zhegrova u transferua te Lille në janar të 2022-s nga Bazeli për 7 milionë euro, por tani vlera e kartonit të tij është dyfishuar.

#### Mourinho arrin marrëveshje me Fenerbahçen

Jose Mourinho do të rikthehet të punojë si trajner. Tekniku portugez raportohet se ka arritur një marrëveshje me gjigantin turk Fenerbahçe. Është gazetari i njohur, Gianluca Di Marzio, që raporton se Mourinho ka arritur marrëveshje dyvjeçare me Fenerbahçen. Portugezi është i papunë qëkur u largua nga skuadra e Romës, të cilën e dërgoi në dy finale radhazi, atë të Ligës së Konferencës dhe atë të Ligës së Evropës. Portugezi ka drejtuar edhe Chelsea, Porton, Manchester Unitedin, Tottenham Hotspurin dhe Real Madridin.

#### Gasperini: Dua Realin në finalen e Superkupës së Evropës

"Në finalen e Ligës së Kampionëve ne mbështesim Real Madridin". Kështu shprehet Gian Piero Gasperini, trajneri i Atalantës, për ndeshjen mes spanjollëve të Ancelottit dhe Borussia Dortmundit. "Nuk kemi asgjë kundër Borussia, me të cilën jemi përballur edhe vite më parë në Evropa Ligë, por finalen e Superkupës së Evropës në Varshavë më 14 gusht me Real Madridin do të ishte më prestigjiozi i mundshëm", ka thënë Gasperini. Me një sy në Superkupën e Evropës, Gasperini praktikisht i ka shlyer rezervat për të ardhmen e tij, e cila, pavarësisht prej miqësive të shumta, do të vazhdojë të jetë në Atalanta. "Me fitoren në Evropë kam marrë oferta edhe nga jashtë, por jo, nuk ka më kohë. Edhe tani kam pasur një ofertë të bukur nga Premierë Liga, diçka e fundit, por Italia më pëlqen shumë" ka deklaruar Gasperini.

#### Cavani pensionohet nga Kombëtarja e Uruguait

Sulmuesi Edinson Cavani nuk do të grumbullohet më me Kombëtaren e Uruguait. Sulmuesi lajmëroi së fundmi tërheqjen nga ekipi kombëtar me idenë për t'u fokusuar tashmë vetëm tek Boca Juniorsi në Argjentinë. 37-vjeçari debutoi me Uruguain në vitin 2008, teksa është edhe golashënuesi i dytë më i mirë në historinë e kombëtares. Në njoftimin e tij për tërheqjen nga Uruguai, Cavani falënderoi ekipin kombëtar për të gjithë rrugëtimin dhe për atë që i kishte mësuar gjatë karrierës, ndërsa theksoi se tashmë kombëtarja e tij do të kishte një tifoz më shumë në tribuna.

## Shefi i Ferrarit: Fitorja në Montekarlo do ta rrisë besimin e ekipit

Ferrari duket se ka rilindur këtë sezon, me dy fitore në 8 garat e para sezonale në Formula 1. Suksesi në pistën qytetase të Montekarlos nga Charles Leclerc shihet si një motivim për "kokëkuqen", që synon të bëjë një paraqitje të mirë edhe pas 10

ditësh në Kanada. Shefi i Ferrarit, Frederic Vasseur, njeriu që ka vënë rregull të skuadra, ka thënë: "Në tri garat e fundit ne kemi qenë gjithmonë brenda një të dhjetës së sekondës nga rivalët. Është një kampionat emocionues, me gjashtë makina

që mund të luftojnë për pole çdoherë, kështu që ne duhet të qëndrojmë të fokusuar në ngjarjet individuale që na presin. Unë dua që ekipi të vazhdojë të përmirësohet në çdo drejtim. Edhe nëse po ecim mirë, ky është vetëm fillimi. Unë insisto

gjithmonë në të njëjtin mesazh. Të gjithë bëjnë një ndryshim në performancën e Ferrarit në pistë. Të gjithë janë përgjegjës për rezultatin si kur gjërat shkojnë keq ashtu edhe kur fitojmë. Fitorja e Leclerc ishte e veçantë, sepse Charles e kishte pritur për një

kohë të gjatë dhe kishte humbur disa mundësi në të kaluarën. Fitorja në shtëpinë e tij do t'i jap atij më shumë besim te vetja dhe do ta rrisë besimin e ekipit. Morali është i lartë e po shtyjme në drejtimin e duhur", ka thënë drejtori i "kokëkuqes".











## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

